

## MËKATET QË DOMINOJNË JETËN TONË DHE RISTRUKTURIMI RRËNJËSOR I JETËS

### HYRJA

- Ndryshimi është një nga përjetimet e përditshme më të rëndësishme për një të krishterë, por gjithashtu edhe më i vështiri.
- Nga vetë natyra ne i rezistojmë ndryshimeve dhe personat në këshillim u bëjnë rezistencë ndryshimeve në jetën e tyre.
- Megjithatë ne duhet të ndryshojmë në mënyrë që t'i bindemi Jezus Krishtit (Luka 9:23-24)
- Ndryshimi fillon në momentin kur bëhemi të krishterë.
- Si këshillues të krishterë, si mund ta lehtësojmë këtë ndryshim?

### I. MËSO NGA EFESIANËVE 4:22-24

#### A. Ndryshimi është proces me faktorë të dyfishtë.

Parim i rëndësishëm: Nuk do t'i ngjani kurrë Krishtit nëse vetëm do të hidhni tutje zakonet e këqija. Ato duhet të zëvendësohen me mendime dhe veprime të ngjashme me të Krishtit. Zakonet në vetvete nuk janë të këqija, Zoti na krijoi të tillë. Por kur zakonet bëhen të këqija, ato duhet të ndryshohen.

#### 1. Hapi i Parë është të **zhveshësh jetën e vjetër**

- a. Të heqësh dorë nga **cilësitë** e jetës së vjetër
- b. Të heqësh dorë nga nga **sjellja** e jetës së vjetër

#### 2. Hapi i Dytë është të **veshësh jetën e re.**

- a. **Cilësitë** e jetës së re duhet të vishen.
- b. **Sjellja** e jetës së re duhet të vishet.

### USHTRIM

1. Një gënjeshtar rresht së qeni i tillë **kur tregon të vërtetën.** (Efes. 4:25)

2. Një person i inatosur nuk është më i tillë kur në mënyrë aktive kërkon **paqe** (Efes. 4:26-27; Mat. 5:22-26)
2. Një hajdut nuk është më i tillë kur **punon dhe i jep atyre në nevojë** (Efes. 4:28)
4. Një person i cili flet keq nuk është më i tillë kur **ndërton të tjerët sipas nevojës që ata kanë**. (Efes. 4:29)
2. Një person i shkujdesur nuk është më i tillë kur **tregon mirësi, dhembshuri dhe falje**. (Efes. 4:30-5:2)
2. Një person i papastër seksualisht nuk është më i tillë kur është **falënderues për partnerin/en ose beqarinë e tyre**. (Efes. 5:3-4)
7. Të alkoolizuarit nuk janë më të tillë **kur mbushen me Frymën** (Efes. 5:18; Kol. 3:16)

\*\*\*\*\*

## II. RISTRUKTURIM RRËNJËSOR I JETËS

### A. Mëkatet që dominojnë jetën tonë kërkojnë masa radikale.

Mëkate të tilla përfshijnë varësinë ndaj pijes, homoseksualitetin, varësinë ndaj drogës, abuzimet fizike, inat i pakontrolluar, gënjeshttrat e zakonshme, epshet, masturbimi, pavendosmëria, vjedhja etj ...

1. Heqja radikale (Mat 5:27:30)
2. I krishteri “duhet ta ketë **shumë të vështirë** (në mos të pamundur) për të rënë **në të njëjtin mëkat sërish.**”

### B. Disa hapa për ristrukturim rrënjësor të jetës janë:

1. **Kthimi në besim ose Rilindja**
2. Pranimi dhe rrëfimi i mëkatit të rebelimit ndaj Perëndisë së Shenjtë.
3. Fryte në përputhje me pendimin, si për shembull:
  - a) **Braktisja** e praktikave mëkatore dhe e lidhjeve me to. (I Kor. 15:37)
  - b) **Rivendosja** e orareve të aktiviteteve etj.
  - c) **Ristrukturimi** i të gjithë jetës sipas parimeve biblike me anë të fuqisë së Frymës së Krishtit.
  - d) Të mos e lejojmë më veten “**të nënshtrohemi**” (1 Kor. 6:12)

Adoptimi i praktikave rrënjësisht të reja, lidhjeve, aktiviteteve, orareve do të ndihmojë për të jetuar një jetë **që e nderon Krishtin**.